



REPUBLIKA E SHQIPERISË MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 633 Prot.

Tiranë, më 10.05 2017

VENDIM Nr. 72, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor të ri "Kërkime Arkeologjike e gjuhësore në trevën e Bishqemit, lugina e Shkumbinit, Kërkime Gjuhësore e Arkeologjike në zonën e Funarit, qarku Elbasan"*, me bashkëautorë të projektit Prof. As. Dr. Ylli Cerova (Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Qendra e Studimeve Albanologjike Ballkanologjike, Elbasan), Prof. As. Dr. Albert Riska, (Universiteti "Aleksandër Xhuvani", FSHH), paraqitur nga Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Fakulteti i Shkencave Humane, Qendra e Studimeve Albanologjike-Ballkanologjike (QSAB), Elbasan,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor të ri "Kërkime Arkeologjike e gjuhësore në trevën e Bishqemit, lugina e Shkumbinit, Kërkime Gjuhësore e Arkeologjike në zonën e Funarit, qarku Elbasan"*, me bashkëautorë të projektit Prof. As. Dr. Ylli Cerova (Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Qendra e Studimeve Albanologjike Ballkanologjike, Elbasan), Prof. As. Dr. Albert Riska, (Universiteti "Aleksandër Xhuvani", FSHH), paraqitur nga "Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Fakulteti i Shkencave Humane, Qendra e Studimeve Albanologjike-Ballkanologjike (QSAB), Elbasan, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

- Zbulimi i vendbanimeve të reja dhe zgjerimi i studimeve në sitet e njohura më parë, përcaktimi i shtrirjes hapësinore dhe kronologjike, formës dhe karakteristikave strukturelle e ekonomike të tyre gjatë Periudhës së Antikitetit të Vonë dhe Mesjetës;
- Përcaktimi i disa prej aspekteve kryesore jetësore të komuniteteve, kryesisht atyre të lidhura me aktivitetet sociale-ekonomike;

Arritura e këtyre qëllimeve lidhet me një seri objektivash specifike, që renditen si më poshtë:

- Identifikimi i siteve arkeologjike, strukturave arkitektonike, dhe gjurmëve të tjera të aktivitetit human, që i përkasin harkut kohor midis Periudhave të Antikitetit të Vonë dhe Mesjetës.
- Studimi, vlerësimi dhe analizimi i të dhënave arkeologjike në funksion të zbulimit të vendbanimeve dhe përcaktimit të karakteristikave të tyre në lidhje me aktivitetet ekonomike dhe territorin, gjatë periudhave në studim.

- Shtrirjen e kërkimit arkeologjik edhe në Periudha të tjera studimi: Antikitet dhe Mesjetë e Vonë; për identifikimin dhe regjistrimin e të dhënave me qëllim plotësimin e hartës arkeologjike të luginës.
  - Trajnimin e studentëve me metodat e mbledhjes dhe dokumentimit të informacionit arkeologjik në terren dhe laborator si edhe njohjen dhe aftësimin e tyre me praktikat e përdorimit të shkencave kompjuterike në fushën e arkeologjisë.
  - Shpërndarja e njohurive mbi arkeologjinë, trashëgiminë kulturore dhe historike të Luginës së Shkumbinit nëpërmjet kryerjes së aktiviteteve edukative, me studentët e Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë do të jetë periudha kohore e nevojëshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2017.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETARI KKA  
RUDINA ZOTO

